**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **POLICIA E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-24-1073-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **SHËRBIMET E SIGURIMIT TPL, TPL PLUS DHE KASKO PËR AUTOMJETET E PK-SË**

# ANKESË

## 1. Identifikimi i ankuesit*

| | |
|---|---|
| Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj | **Kompania e Sigurimeve " SCARDIAN " J.S.C.** |
| NUI | **601108386** |
| Adresa | **PERANDORI JUSTINIAN NR.3** |
| Vendi | **PRISHTINË** |
| Kodi postar | **-** |
| Numri Telefonit | **049 90 90 89** |
| Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj | **Leonora Demaj** |
| Adresa elektronike | **leonora.demaj@scardian.com** |
| Data e parashtrimit të ankesës | **03.05.2024** |

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

Ankesa i përket grupeve:

**SHËRBIMET E SIGURIMIT TPL, TPL PLU S DHE KASKO PËR AUTOMJETET E PK-SË[]SHËRBIMET E SIGURIMIT TPL PER MOTOQIKLETA DHE RIMORKIO.**

**Tenderi i Policise se Kosoves eshte hap ne njoftimin per kontrate mr dt 18.03.2024 ndersa pas ankeses eshte shtyer me dt 27.03.2024**

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

***Po*** ☒ ***Jo*** ☐

## *6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve*

*A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

**Po** ☒ **Jo** ☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.*

**Dispozitata e shkelura :**

**LPP nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092,**

**Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;**

**Neni 27 Dosja e Tenderit;**

**Neni 28 Specifikimet Teknike;**

**Neni 59 Ekzaminimi ,vlersimi dhe Krahasimi I tendereve**

**Neni 61 Tenderet jo-Normalisht te Ulet**

**Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale.**

**UDHËZUESI Nr.001/2022 per Prokurim Publik**

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**LPP nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092,**

**Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;**

**Neni 27 Dosja e Tenderit;**

**Neni 28 Specifikimet Teknike;**

**Neni 59 Ekzaminimi ,vlersimi dhe Krahasimi I tendereve**

**Neni 61 Tenderet jo-Normalisht te Ulet**

**Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale.**

**UDHËZUESI Nr.001/2022 per Prokurim Publik**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

**8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Pas verifikimit të dokumenteve të operatorit ekonomik **KS Dukagjini sh.a.**, janë vërejtur shumë shkelje në procedura dhe kërkesa. Jane verejtur se ne dosjen e tenderit ka shkelje te procedurave ne 5 pika si me poshte;

***1.Ndarja e tenderit ne LOT 1 &LOT 2***

***2. Prezentimi I kontrateva te noterizuara te autoserviseve,***

***3. Autorizimet e dhena per nenshrkimin e ketij tenderi,***

***4. Dokumenti I prezentuar per "Vendimi nga Kryeshefi Ekzekutiv" i prezentuar pa protocol.***

***5. Shkelja ne cmimi I dhene I cili eshte jasht normales i ulet.***

Për më tepër, do të mundohemi të ju përshkruajmë të gjitha pikat që ne mendojmë se ka shkelje dhe operatori ekonomik **KS Dukagjini sh.a.**, duhet të eliminohet nga ky proces i tenderimit. Po fillojmë nga shkelja e parë:

1.Ndarja e tenderit ne LOT 1 &LOT 2

Ndarja e kontratave ne Lote sipas udhezimit nr 001/2023 per Prokurimin Publik pika 4.Ndarja e kontratave ne Lote 4.1 AK mund ta ndaj aktivitetitn e prokurimit ne Lote homogjene apo heterogjene .

Duke e ndare produktin TPL ne dy pjese ndersa duke e bashkuar me produktin vullnetar ne Lot 1 produktin TPL eshte ne kundershtim me Udhezimin dhe Ligjin e autopergjigjesise pasiqe keto tarifa dhe produkte rregullohen sipas ligjit te BQK-se,me ndarje te nje produkti obligativ i cili ka tarifa fikse per te gjitha kompanite e sigurimeve .

Per kompanite e sigurimit per gjithesecilin produkt eshte nje licence e veqante nga BQK per operim dhe nuk mundeni te nje produkt vullnetar ta beni bashke me nje produkt obligativ ,ndersa produktin obligativ ta ndani ne dy LOT .

Nuk ka ndodhe ndonjehere qe nga Policia e Kosoves te beje ndamje te produkteve ne tenderet e viteve te kaluara .

*2. Prezentimi I kontrateva te noterizuara te autoserviseve,*

Nga prezantimi i kontratave për shërbimet sipas kërkesës numër 2, në pjesën e përshtatshmërisë së dosjes së tenderit, kërkohet që si dëshmi të paraqitet siç është e shkruar më poshtë:

**Deshmi 2 –OE duhet te deshmoje se ka servise ose marrveshje me nje servis ku do te rregullohen automjetet. OE duhet te prezentoj marreveshjen ne mes te dy paleve. Marveshja duhet te jete e noterizuar. duhet te jete e noterizuar**.

Operatori ekonomik K.S. Dukagjini sh.a. nuk ka dorëzuar kontrata të noterizuara dhe të nënshkruara në prani të Noterit; në vend të tyre, ka dorëzuar kopje të verifikuar nga noteri. Kontratat janë bërë kopje dhe përmbajnë titullin **"VERTETIMIN E DOKUMENTIT ORIGJINAL"**, siç thuhet në përmbajtjen e kontratës së noterit. Në të njëjtin dokument, noteri shpjegon në shkrim: **"Vërejtje: Ky vertetim nuk përfshin vertetimin e nënshkrimeve."** Pra, para noterit nuk janë paraqitur palët nënshkruese të kësaj kontrate, por është paraqitur një zyrtar i operatorit ekonomik duke bërë kopje të këtyre kontratave. Si pasojë, rezulton se në këto kontrata mund të nënshkruajë kushdo dhe identiteti i personave në këto kontrata nuk është verifikuar nga noteri. Për dallim nga paraqitja e kontratave tona, K.S. Scardian JSC, ka bërë nënshkrimin e kontratave në prani të noterit me të gjitha palët prezente, dhe në përmbajtjen e kontratës së noterit thotë: **"Vertetoj se nënshkrimet e vendosura nga Kompania e Sigurimeve Scardian JSC SH.A – Hekuran Neziri dhe [emri i autoservisit], janë vendosur në praninë time në dokumentin e titulluar 'Kontrata me shërbime për riparimin e automjeteve"**.

Sikurse shihet edhe nga dosja e tenderit në pjesën e kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 dhe 9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional, kërkohet që **"Dëshmi 2 – OE duhet të dëshmojë se ka shërbime ose marrëveshje me një servis ku do të rregullohen automjetet. OE duhet të prezentojë marrëveshjen në mes të dy palëve. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar"**, pra nuk është kërkuar që marrëveshja të jetë kopje e noterizuar.

Në pjesën e tenderit, specifikimet për përputhshmërinë e kërkesave, në pikën **c) Vertetimi nga Gjykata**, është theksuar që; **c) Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - origjinal kopje e noterizuar**, në këtë pjesë kërkohet që kopjet të jenë të verifikuara nga noteri. Ndërkohë, në lidhje me **kërkesat për aftësi teknike dhe/ose profesionale, në pikat 9.1 dhe 9.2**, lidhur me **Kapacitetin Teknik dhe Profesional, në "Dëshmi 2"**, kërkohet që marrëveshja te jetë e noterizuar nga te dy palet prezent tek noteri, siç e kemi paraqitur ne **K.S. Scardian J.S.C**. Pra, kerkesa e autoitetit kontraktues shihet qarte qe ne kete pike ka kerkuar 'kopje te noterizuar' kurse ne piken tek

‘Deshmia 2’ ka kerkuar marreveshje te noterizuar. Me kete vertetohet qe operatoir ekonmik K.S. Dukagjini ka bere shkelje ne kete pike.

Nga kjo, vërehet se Operatori Ekonomik **KS Dukagjini sh.a.** nuk e ka përmbushur kriterin e përcaktuar me kushtet e tenderit nga ju, pasi që kontratat për shërbimet nuk përmbushin kushtin e **aktit notarial**.

Gjithashtu, në kontratën e autoservisit të **Porsche Kosova**, personi që ka nënshkruar atë nuk është person i autorizuar sipas ARBK-së. Personi që ka bërë nënshkrimin është **Selim Berisha**, ndërsa sipas ARBK-së, personat e vetëm të autorizuar për nënshkrimin e kontratave janë **Fioret Pruthi** dhe **Danie Wukowitsch**. Edhe në këtë rast, operatori ekonomik **K.S. Dukagjini sh.a.** nuk ka arritur të përmbushë kërkesat e përcaktuara në dokumentacionin e tenderit.

Njeherazi edhe zbritjet e ofruara nga keto marreveshje nuk qendrojne pasi qe te njejtat nuk jane nenshkruar ne prani te noterit dhe kur te largohen nga kalkulimi cmimi ndryshon me shume se 2% e cila eshte e lejuar me ligjin e prokurimit.

***3. Autorizimet e dhena per nenshrkimin e ketij tenderi,***

Në pjesën e Autorizimeve, duket se autorizimi i dorëzuar është nënshkruar në vitin 2021 dhe sipas këtij autorizimi, përfaqësuesi i biznesit është Korab Lluka, ndërsa në bazë të ARBK-së si përfaqësues i autorizuar është **Muhamet Boja**. Te dy personat, si **Korab Lluka** dhe **Valmir Gashi**, kanë letrat e identitetit të skaduara, duke bërë kështu dokumentin e pavlefshëm, pasi dokumenti në bazë të të cilit janë identifikuar këta persona është skaduar. Po ashtu në lidhje me vertetimin për nënshkrimin e tenderit në emër të **z. Valmir Gashit**, autorizimi i paraqitur ka të bëjë me çështjet procedurale të tjera që operatori ekonomik ka përballë organeve komunale dhe qendrore, dhe nuk përcakton autorizimin për nënshkrimin e procedurave të tenderit, ashtu siç është pranuar nga ju. Në krahasim me autorizimin tonë të **K.S.SCARDIAN j.s.c.** të paraqitur, e cila është qartësisht specifikuar se personi i autorizuar në këtë rast është i lejuar të kryejë të gjitha veprimet dhe procedurat administrative për nënshkrimin e kontratës së tenderit, të gjitha deklaratat, si dhe të gjitha dokumentet që lidhen me tenderin e **Policisë së Kosovës - "Shërbimet e Sigurimit TPL, TPL Plus dhe Kasko për automjetet e PK**", **me numrin e prokurimit 214-24-1073-2-1-1**. Pra, nga çfarë u prezantua më lart, është e qartë se operatori ekonomik në rastin e parë nuk ka paraqitur dokumentin, pasi nuk e kishte në pronësi në momentin kur eshte derguar tenderi ne fillim. Ai ka paraqitur këtë autorizim ne momentin kur eshte kerkuar nga autotiteti kontraktues si sqarim I tenderit dhe i cili nuk është i dedikuar për këtë procedurë të tenderimit. Kjo tregon se **z. Valmir Gashi** nuk posedon një autorizim të plotë për nënshkrimin e tenderëve të kompanisë, ashtu siç është përshkruar nga operatori ekonomik."

***4. Dokumenti I prezentuar per "Vendimi nga Kryeshefi Ekzekutiv" i prezentuar pa protocol.***

Nga dokumenti i prezantuar për sqarimin e kërkuar, me titullin **"Vendimi nga Kryeshefi**

**Ekzekutiv"**, dokumenti i pranuar nuk përmban numrin e protokollit, duke e bërë këtë dokument të mangët dhe të pabesueshëm për autoritetin kontraktues.

***5. Shkelja ne cmimi I dhene I cili eshte jasht normales i ulet - Tenderet jo-Normalisht te Ulet***

Nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori tenderues Dukagjini sh.a., është e dukshme se ky operator ka kryer shkelje flagrante në përcaktimin e çmimit të Sigurimit KASKO. Edhe përkundër faktit se ky operator ka kërkuar mendim nga aktuari i tyre, mund të konstatojmë me bindje se analiza e aktuarit është bazuar në manipulimin e numrave për të arsyetuar gabimin flagrant që është bërë nga operatori.

Në vlerësimin e aktuares të licencuar të kompanisë, thuhet se: "*Sipas të gjitha konstatimeve të paraqitura në shtojcën e bashkangjitur, aktuari i autorizuar i Kompanisë vlerëson dhe arrihet në përfundimin se çmimet dhe tarifat e aplikuar janë në përputhje me politikat e brendshme të Kompanisë, janë të profitabile dhe rentabile (financiarisht të qëndrueshme) për Kompaninë. Te njejtat çmime dhe tarifa, nuk levizin dhe/apo demtojne pragun e likuiditetin dhe solvences se Kompanise, andaj rekomandohet qe Kompania ne cilesin e Operatorit Ekonomik te merr pjese ne tenderin e shpallur nga Autoriteti Kontraktues sipas çmimeve dhe tarifave te aplikuara dhe propozuara si me larte."*

Kerkojme qe te behet nje vlersim nga nje aktuar I pavarur ne lidhje me cmimet dhe vlersimin e aktuarit te Dukagjinit .

Për hir të korrektesisë, si mund të jenë tarifat në përputhje me politikat e brendshme të kompanisë kur, tarifat e aplikuar në këtë tender janë pothuajse absurde? Shtrohet pyetja se çfarë kalkulimesh janë bërë për të caktuar tarifën, kur për shembull, për një automjet të vitit 2024 me vlerë të caktuar nga Autoriteti Kontraktues në 31,795.00 €, çmimi për sigurimin KASKO për një vit është vetëm 0.99 EUR/Cent? Qe I bije qe nga minimum per momentin I tarifes se KASKO-se 1.7% pa shpenzime te tjera qe I derivohen produktit (sipas te dhenave nga buletini I BQK-se) qe operatori ekonomik te zbatoj nje zbritje prej perafersisht 99.75%. Për cfarë profitabiliteti dhe rentabiliteti flitet? Per cfare perputhje te politikave te brendshme te kompanise flitet?

Kasko Tregues

| | 2022 | 2023 | AVG |
|---|---|---|---|
| Frekuenca e Demit | 37% | 33% | 35% |
| Demi mesatar | 894 | 1,003 | 948 |
| Primi rrezikut | 328 | 335 | 332 |
| SI | 20,000 | 20,000 | 20,000 |
| Tarifa | 1.60% | 1.70% | 1.70% |

Analiza ne baze te te dhenave zyrtare nga Banka Qendrore e Kosoves.

Linku - https://bqk-kos.org/mbikeqyrja-financiare-2/mbikeqyrja-e-sigurimeve/tarifat-dhe-

buletini-statistikor/

Mbikqyres i industries se sigurimeve ne Kosoves eshte Banka Qendrore e Kosoves dhe njeherit kerkojme nga ju qe te kerkoni sqarim nga ta ne lidhje me keto cmime se a mund te ofrojne profitabilitet nje portofolio me vlere siguruese 416,429.52 EUR (cmimi per njesi) e automjeteve te cilat jane ne rruge 24/7, te sigurohen per te gjitha demet 100% mbulim, pa ndonje franshize apo pjese te zbritshme per vetem 64.61 EUR per tre vite te kontrates.

Cmimi mesatar ne treg per vitin e kaluar te produktit KASKO ne te gjithe industrine eshte afer **550.00 EUR** per vetur dhe cmimi I ofruar nga operatori ekonomik KS Dukagjini sh.a. eshte dikun rreth **1.10 EUR**, nese perkthehet kjo ne perqindje atehere I bie qe nje automjet eshte siguruar me **0.2%** nga cmimi mesatar I tregut.

Po ashtu, bazuar në legjislacionin dhe rregulloret aktuale të Prokurimit publik, në rregulloren e prokurimit publik me **nr 001/2022, Neni 41, paragrafi 41.3 thotë se:**

*"Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:*

*çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;*

*çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;*

*janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë."*

Nga kjo rregullore rezulton që në të dy pikat, autoriteti kontraktues duhet të konsiderojë këtë tender si një tender jo normalisht të ulët dhe ta refuzojë, pasi operatori ka çmimin më shumë se 30% më të ulët se mesatarja e tenderëve që janë aplikuar, dhe më shumë se 10% më të ulët se tenderi i dytë me çmimin më të ulët.

Nga të gjitha shkeljet e prezantuara më lart në këtë procedurë të tenderimit, autoriteti kontraktues duhet automatikisht të eliminohë operatorin ekonomik K.S. Dukagjini sh.a. dhe të shpallë fitues ofertën e operatorit ekonomik K.S. Scardian J.S.C., pasi është e

vetmja ofertë që përmbush të gjitha kushtet e kërkuara nga ju si autoritet kontraktues.

**Kërkojmë nga ju që për të gjitha pikat qe janë shkelur,sa I perket tarifave te Kaskod të kontaktoni organin mbikqyrës të sigurimeve në Kosovë, Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), dhe të kërkoni sqarim se a jane ne perputhje cmimet e ofruara .**

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Kompanise tone do ti shkaktohet deme ne emer te fitimit te humbur si dhe ulje e autoritetit ne industrine e sigurimeve**

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
*e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
*f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
*g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*